



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI CIVIL**

**Nr. 11243-00907-00-2015 i Regj. Themeltar**

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga gjyqtarët:

<b>Artur KALAJA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ervin PUPE</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Dariel SINA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Margarita BUHALI</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Enton DHIMITRI</b>	<b>Anëtar</b>

në datë 18.11.2022 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale, që i përket:

**PADITËS:** **Avokatura e Shtetit Tiranë**

**I PADITUR:** **Agjencia e Trajtimit të Pronave ish Agjencia e Kthimit dhe e kompensimit të Pronave**  
**Lirije Vasiu**  
**Fatime Jupi**  
**Liza Lamcaj**  
**Kico Simo**  
**Gathur Kurti (Simo)**  
**Nadjezhda Ymeraj**  
**Andrea Simo**  
**Ollga Martini**  
**Rustem Rustemaj**  
**Nevi Rustemaj**  
**Inesa Rustemaj**  
**Arjana Rustemaj**  
**Erlul Rustemaj**  
**Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Vlorë ish Zyra Vendore e regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë**

**OBJEKTI:**

Anullimin e Vendimit nr. 383, datë 04.11.2008 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Vlorë.  
Fshirjen e regjistrimit të pronësisë me nr. Hipotekor 225 datë 26.04.2010, në zonën kadastrale 3844 Vuno, Himarë, me sipërfaqe 1134 m<sup>2</sup>, 1086 m<sup>2</sup>, 468 m<sup>2</sup>, 7599 m<sup>2</sup> në emër të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Ollga Leo Simo.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 5, germa “e” dhe 14 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, Kodi i Procedurave Administrative nenet 9, 18/b, 115 e vijues; Ligji nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe Kompensimin Pronës” i ndryshuar.

**KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Artur Kalaja dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N**

**1. Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë** me vendim nr. 1986 akti, datë 07.11.2013 ka vendosur:

“Të mos pranoje kërkesën e palës së paditur për nxjerrjen nga juridiksioni gjyqësor të çështjes civile administrative nr. 1986 Akti, datë 07.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.  
Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë...”

2. Në këto kushte, **Gjykata e Apelit Tiranë** me vendimin nr. 734, datë 11.11.2014 ka vendosur:

*“Dërgimin e çështjes civile nr. 622 akti, datë 06.03.2014 Gjykatës së Lartë Tiranë.”*

3. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin datë 18.06.2015 ka vendosur kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara.

4. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 28.10.2022 ka vendosur: *Çështja nr. 11243-00907-00-2015, datë 21.04.2015, të kalojë për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë për të vijuar procedurën e njësimi të praktikës gjyqësore.*

5. Në referim të nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi i Kolegjit Civil për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruara për njësim, si dhe u komunikohet palëve ndërgjyqëse, përveç publikimit të tij në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 481 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Të caktojë datën 15 dhjetor 2022, për shqyrtimin në seancë gjyqësore publike, të çështjes nr. 11243-00907-00-2015 regjistri themeltar, datë 21.04.2015, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore.

2. Në zbatim të nenit 481, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore janë:
  - (i) Referuar rregullimeve të bëra me ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese, për rastet kur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë nuk ka marrë në shqyrtim ankimin e ushtruar nga subjektet e legjitimuara kundër vendimeve të ish-komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të ish-Komisioneve Vendore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe/ose Zyrave Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit të saj, subjekti i interesuar ka të drejtë ose jo ti drejtohet gjykatës dhe objekt kundërshtimi do të jetë vendimi i nxjerrjes jashtë juridiksionit apo dhe themeli i çështjes?
  - (ii) A është vendimi i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit një akt absolutisht i pavlefshëm dhe a duhet të goditet veçmas ky akt në gjykatë nga subjekti i interesuar apo gjykata mund të konstatojë kryesisht pavlefshmërinë e tij, gjatë zgjidhjes në themel të çështjes?
  - (iii) Në rastet kur gjykata konkludon se çështja duhet të ishte shqyrtuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, ajo do të vendosë vetëm nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të saj apo do të detyrojë Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë të marrë çështjen në shqyrtim?
3. Ky vendim publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.
4. Në zbatim të nenit 481, paragrafi i pestë i Kodit të Procedurës Civile ngarkohet sekretaria gjyqësore t’i komunikojë palëve ndërgjyqëse një kopje të këtij vendimi.